

VENDIM
Nr.92, datë 6.8.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË
“HIDRO INVEST 1” SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pikat 1, germa “a”, dhe 8, të ligjit 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”, dhe 10, të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21 datë 4.4.2007; nenit 18, pika 1, germa “a”, të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.8.2008, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hidro Invest 1” sh.p.k., për t’u licensuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec Stranik dhe Zall Tore,

Dhe konstatoi:

- paraqitjen, konform përcaktimeve të Rregullores së Procedurave të Licencimit, të dokumentacionit dhe deklaratave të kërkuara nga ERE kur dokumentacioni mungon,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Hidro Invest 1” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec Stranik dhe Zall Tore.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta